



Deklaratë për shtyp

ADRIPASS

Integrating multimodal connections in the Adriatic Ionian Region

Durrës

15.02.2019, 11:00

Takimi i tretë i Komitetit Drejtues të projektit ADRIPASS u zhvillua në datat 06 dhe 07 Shkurt 2019 në qytet - portin e Ploces, Kroaci.

Përfaqësuesi i Portit të Ploces, Z. Darko Plecas, hapi ditën e parë të takimit e cila vijoi me diskutime dhe prezantime teknike rreth finalizimit të metodologjisë për lehtësimin e transportit në zonën Adriatiko – Joniane.

Pjesa e dytë e ditës vijoi gjithashtu me diskutime teknike ku secili partner prezantoi planin e zhvillimit rreth sistemeve të IT që posedon secili prej tyre. Porti i Durrësit, i cili aktualisht nuk ka një sistem të integruar IT, po zhvillon një studim për implementimin e tij. Ky sistem do të bashkojë dhe lehtësojë komunikimin e komunitetit portual.

Dita e dytë e takimit ju dedikua veçanërisht paketës së komunikimit në të cilën janë specifikuar aktivitetet e ndryshme që do të zhvillohen në muajt në vijim për të bërë një prezantim më të gjërë të qëllimeve të projektit. Artikuj në shtypin e shkruar, konferenca, deklarata për shtyp, video promovionale etj. do sjellin për të interesuarit të gjithë informacionin e nevojshëm rreth ADRIPASS.

Në muajin Qershor Autoriteti Portual Durrës do të zhvillojë një konferencë për promovimin e projektit.



Nëpërmjet rezultateve të projektit ADRIPASS dhe në veçanti përmes strategjisë ADRIPASS për rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së transportit multimodal, kapacitetet e planifikimit të palëve të interesuara të transportit (terminalet portuale / operatorët logjistikë, Ministritë e Transportit, Komisioni Evropian, Koordinatorët e Korridorit TEN-T) do të përmirësohen ndjeshëm, pasi që të gjithë po përballen me të njëjtat sfida në lidhje me aksesin e transportit multimodal dhe efikasitetin e rrjetit në TEN-T në rajonin ADRION (nga porti në brendësi).

Personi i kontaktit:

Fationa Muhametaj

Adresa: L. 1 Rr "Tregtare" Durrës, Albania

e-mail: f.muhametaj@apdurrës.com.al

Tel. nr.: +355 52 293 430

Website-i i projektit: <https://adripass.adrioninterreg.eu/>

Llogaritë në mediat sociale: <https://www.linkedin.com/company/adripass-euproject>

facebook: Adripass EuProject